



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

RELACION
PROJEKTVENDIM
PËR

CAKTIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, PËR DISA NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE, TË DATËS 9 NËNTOR 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjës “n” dhe dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 93, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar, mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 93, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, pika 3 dhe 4 të Udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”, mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private, kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimit fqinje.

Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, paraqet propozimin për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në ndërtesa private në pronësi të personave fizikë e juridikë, duke paraqitur dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe të dhëna të tjera për efekt të plotësimit të kriterëve në përcaktuara në kuadrin ligjor. Kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ, propozimi paraqitet vetëm një objekt.



Në KQZ janë administruar deri në momentin e hartimit të këtij relacioni propozimet e kryetarëve të njësisë të vetëqeverisjes vendore për caktimin e vendndodhjes së 37 qendrave të votimit në ambiente private, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Partia Demokratike, pasi u njoh me projektvendimin, vërejnë problematika në dy QV në ambiente private, përkatësisht:

- QV nr. 2521 – ndodhet tek lokali i Baftjar Muçës, në fshatin Shtëpanj, në katin e dytë, me shkallë të vështira për ngjitje;
- QV nr. 2534 – gjithashtu në katin e dytë, me akses të vështirë për votuesit, ndaj propozojmë ndryshimin e vendndodhjes së saj.

Lidhur me pretendimin e Partise Demokratike, për këto dy qendra votimi do të bëhen verifikimet përkatëse dhe nuk do të përfshihen në këtë projektvendim.

Për bashkitë Vlorë, Berat, Cërrik dhe Tepelenë, propozimet përmbushin kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, nenet 3 dhe 4, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të ndryshuar.

Nga të dhënat rezultojnë se;

- a) 35 QV në ambiente private që do të miratohen për bashkitë Vlorë, Berat, Cërrik dhe Tepelenë;
- b) për të gjitha raste ku vendndodhja e QV është propozuar në ndërtesa private deklarohet se nuk përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmi të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore;
- c) nuk janë shtëpi banimi;
- d) ambientet propozuara për caktimin e vendndodhjes së QV plotësojnë kriteret teknike;
 - janë afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
 - janë me ndriçim të mjaftueshëm;
 - janë përgjithësisht në katet e para të objekteve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të vetëqeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”

Erion META - Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ - Drejtoria e Ligjshmërisë

Anila RUÇO - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

protnumber

Data: xxxx

Nr: xxx

Ora: xxxx

VENDIM
PËR

CAKTIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË
NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR
KRYETAR BASHKIE, NË DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 9
NËNTOR 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n” dhe 2, nenit 93, pika 2 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar në këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: xxxx Nr: xx
Ora: xxx



“Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”

Nr.	Bashkia	Njësia Adm	Qv	Vendndodhja e QV
1	Vlorë	Rajoni nr. 1	4430	Ambient shërbimi Engjëll Dine
2	Vlorë	Rajoni nr. 1	4430/01	Ambient shërbimi Engjëll Dine
3	Vlorë	Rajoni nr. 2	4505	Ambient privat z. Kajtas Alikaj
4	Vlorë	Rajoni nr. 2	4505/01	Ambient privat z. Kajtas Alikaj
5	Vlorë	Rajoni nr. 2	4505/02	Ambient privat z. Kajtas Alikaj
6	Vlorë	Rajoni nr. 4	4476	Universiteti Jo-Publik "Reald"
7	Vlorë	Rajoni nr. 4	4482	Universiteti Jo-Publik "Reald"
8	Vlorë	Rajoni nr. 4	4482/01	Universiteti Jo-Publik "Reald"
9	Vlorë	Rajoni nr. 4	4482/02	Universiteti Jo-Publik "Reald"
10	Vlorë	Rajoni nr. 5	4452	Ambient privat zj. Sadete Xhafellari, lagjja "28-Nëntori", Rr. "Sh. Alimerko"
11	Vlorë	Rajoni nr. 5	4452/01	Ambient privat zj. Sadete Xhafellari, lagjja "28-Nëntori", Rr. "Sh. Alimerko"
12	Vlorë	Qendër Vlorë	4421	Ambient privat z. Piro Subashi, Zvërnec
13	Vlorë	Qendër Vlorë	4421/01	Ambient privat z. Piro Subashi, Zvërnec
14	Vlorë	Shushicë	4540	Ambient privat z. Mevlan Vallaj, Llakatund
15	Vlorë	Shushicë	4540/01	Ambient privat z. Flamur Hoxhaj, Llakatund
16	Vlorë	Shushicë	4541	Ambient privat z. Rakip Arapi, Drithas
17	Vlorë	Shushicë	4546	Ambient privat z. Dritan Fezaj, Çeprat
18	Cërrik	Cërrik	2517	Ambient privat z. Ferhat Musaj
19	Cërrik	Gostimë	2520	Ambient privat z. Përparim Lala, Malasej
20	Cërrik	Gostimë	2523	Ambient privat z. Leonard Xhika, Shtëpanj
21	Cërrik	Gostimë	2527	Ambient privat z. Bardhul Duka, Çarllatos
22	Cërrik	Gostimë	2531	Ambient privat z. Vladimir Merdani, Shtërmën
23	Cërrik	Gostimë	2531/01	Ambient privat z. Engjellushe Kuqja, Shtërmën
24	Cërrik	Klos	2536	Ambient privat z. Gasjon Latifi, Klos
25	Cërrik	Klos	2536/01	Ambient privat z. Gasjon Latifi, Klos
26	Cërrik	Klos	2539/00	Ambient privat z. Rruzhdi Dunga, Lumas
27	Cërrik	Shalës	2588/01	Ambient privat z. Pasho Allkja, Shalës
28	Cërrik	Shalës	2591	Ambient privat z. Jani Ago, Liçaj
29	Cërrik	Mollas	2544	Ambient privat z. Agron Venari, Dasar
30	Cërrik	Mollas	2544/01	Ambient privat z. Agron Venari, Dasar
31	Cërrik	Mollas	2546	Ambient privat z. Mefa Cërriku, Kamuna
32	Berat	Roshnik	3450	Ambient privat z. Altin Pasho, fshati Vojnik
33	Berat	Sinjë	3356	Ambient privat z. Spiro Xhindi, fshati Galinë
34	Berat	Rajoni nr. 2	3306	Ambient privat z. Bashkim Bejdolli, lagjja Goricë
35	Tepelenë	Tepelenë	4393	Ambient privat, ish-shtëpia e oficerëve